



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 85 / 2021  
Datë: 20 / 05 / 2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 22 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, (Gazeta Zyrtare nr.23/2018, 26.12.2018), si dhe në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) – Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021) Ministria e Drejtësisë nxjerr:

### V E N D I M

1. Z. Ilmi Ademi, i emëruar të ushtroj detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Vushtrrisë i pushon ushtrimi i funksionit të noterit.
2. Vendimi hyn në fuqi me datën 28.05.2021.

### A r s y e t i m

Ilmi (Avdi) Ademi, i emëruar të ushtroj detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Vushtrrisë me vendimin e Ministrit të Drejtësisë Nr.ref.146/2014 të datës 27.03.2014, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare i pushon ushtrimi i funksionit të noterit me datë 28.05.2021.

Andaj bazuar në nenin 22 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2) i Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë, Ilmi Ademi, lirohet nga detyra e noterit.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë



#### Vendimi i dërgohet:

- Noterit,
- Kabinetit të Ministres,
- Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega Vushtrri,
- Odës së Noterëve,
- Departamentit për Profesione të Lira,
- Arkiviot të Ministrisë së Drejtësisë.